

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# nacional

Drejtor:  
**Mujë Buçpapaj**

Adresa: **Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë**  
E-mail: **nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com**

## Si i njoha unë shqiptarët?

Nga **MORELLE SMITH**

Kur regjimi komunist ra, kishte kaos. Shqiptarët s'janë njerez të duruar apo të butë.

vijon në faqen 20

## Gjon Milit & Pikaso

Nga **GJEKË MARINAJ**

Pasqyrimet fotografike të Gjon Milit tërheqin shikuesin drejt botës së tij të pasur artistike, një bote ku mësimi, dinamika, vendosmëria dhe transparenca nuk janë vetëm ato

vijon në faqen 10

## Skender Sherifi ndër 10 autorët më të mirë të vitit 2008 në Europë

vijon në faqen 18

## Majk Tajson:

### Më vjen turp nga vetja

Voal-online - Ish boksiери tregon në prag të daljes së dokumentarit që flet për jetën e tij: „Jam një djalë i mirë, por mos më provokoni. Më pëlqejnë femrat e forta, por dua të dal unë gjithmonë fitimtar ndaj tyre.

vijon në faqen 23



## Të legalizosh demokracinë dhe levizjen e lirë

Nga **Mujë BUÇPAPAJ**

Kur perdja e hekurt ra dhe busti i dikatorit u shemb përdhe, njerëzit parasegjitash kishin shijuar lirinë dhe bashkë me të edhe levizjen e lirë. Një vend i çliruar shtrihej gjithandej, sido me një profil të mungesës së rregullit dhe rendit deri në kaos. Ndërsa me mijëra shqiptarë kapërcyen kufirin shtetëror për të nisur një jetë tjetër në perëndim, disa qindra mijëra të tjerë, nga më të varfërit, zbritën nga thellësitë e vendit kryesisht për në Tiranë dhe Durrës, por dhe në qytete të tjera të mëdha. **vijon në faqen 3**

# Nobelisti Ferid Murati: "Jam krenar që jam shqiptar"

## Krijimi i aleancave

Nga **Gani Mehmetaj**

Nuk ka shqiptar të rritur në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoni e në diasporë që nuk e mban në mend 24 marsin e vitit 1999, mbrëmjen e asaj dite të freskët marsi, kur presidenti Klinton i paralajmëroi bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe. Një datë që kurrë nuk do ta harrojnë shqiptarët, një veprim që kurrë nuk do t'i dalim borxhit, një kthesë historike që, përfundimisht, **vijon në faqen 3**

## Mohimi, si afirmim negativ i opozitës

Nga **Arbër Ahmetaj**

Që nga viti 1991, përpjekjet për të vlerësuar dhe analizuar të shkuarën kanë kaluar nëpër një proces të vështirë. Duke lënë anash problemet e shtypit të lirë, pengesat që u bëheshin gazetarëve për të mbërritur tek burimi i informacionit, dhuna që ushtrohej ndaj tyre etj, do të theksoj një vështirësi tjetër **vijon në faqen 4**

## A e kemi edhe ne Itakën tonë të fjalës publike?

Nga **Emin AZEMI**

Gjallimi njerëzor është varur nga pesha e rëndë e prezencës së njeriut në një vend të caktuar, por edhe nga një peshë tjetër, ajo e fjalës. Nga letërsia kemi shembuj të shumtë në trajtë arketipesh që tipizojnë peshën e qenies dhe të fjalës, si një simbiozë që në brendi krijon motivin për të reaguar ndaj sfiduesve të natyrave të ndryshme. **vijon në faqen 3**



## Monica Beluçi tregon skretet e joshjes së saj!

faqe nr:23

## Sindi Krauford 43 vjeçe si 23 vjeçe

Voal-online - Si dy herë nënë që është, ndjehet „vërtetë mirë” për pamjen e jashtme të saj. Kështu mendon topmodelja e viteve 1990 Cindy Crawford. Bukuroshja 43 vjeçare ka shpalosur trupin e saj përsëri, tashmë për revistën amerikane „Allure”, ku është fotografuar, duke qenë krenare që **faqe nr:22**

**Sekretet e V.I.P.-ve Hollywood:- George Cloone, Sindi Krauford, Naomi Kempbell, Vanesa Redgreiv, Anna Nicole Smith, Klaudia Shifer**

## BOLERO NË VILËN

**E PLEQVE**

Recesion nga Edlira Macaj

Romani nuk ka ngjarje të jashtëzakonshme e të padëgjueshme më parë, ndaj veçorinë nuk e **faqe nr:11**

**Poezi e panjohur të Vilson Bolloshmit**

faqe nr:19

## Intervista me këngëtarët e mirënjohur

**Rati & Edmond Stolia si dhe me drejtorin artistik te ansambllit "Shqiponja" Skërder Ismaili**

**Këngëtarët e preferuar te radio "Nacional" u pergjigjen fansave te tyre...**

**LEXONI faqe 21**



Në foto Rati



Në foto Edmond Stolia

faqe nr:2...	<b>Në BRENDËSI</b>
	<b>Vendlindja e përfolur</b> Tregim nga <b>ZIJA ÇELA</b>
faqe 7	<b>Libri i Fahri Balliut</b> "Zonja e Zezë Nexhmije Hoxha", bestseller ne Paris
faqe 18	<b>KREVATI I RI</b> Poezi nga Andrea Witzke Leavey
faqe 6	<b>RUSIANKA</b> Tregim nga <b>QAZIM D. SHEHU</b>
faqe 6	<b>Tregime nga Viola Isufi, Skërder Hasko, Baardhyl Xhama</b>
faqe 11	<b>Poezi nga ORHAN VELI, IDAJET BAJRI, JORGOS HRONAS, FILIPPO TOMMASO MARINETTI</b>
	<b>LIBRAT E TIM ETI</b> Tregim nga <b>MARTIN MATO</b>
faqe 12-13	<b>100 vjetori i futurizmi</b> Nga: <b>Elida BUÇPAPAJ</b>



*“Excellence in the Creative and Performing Arts” është çmimi më i fundit me të cilin është nderuar poetesha e re amerikane Andrea Witzke Leavey. Ky nderim është një vazhdimësi e mbarë e çmimeve të tjera letrare që ajo ka fituar në të kaluarën dhe një shenjë premtuese për suksesin e saj në ditët që vijnë. Hapësira që disa nga revistat letrare më me zë të Amerikës i kanë kushtuar poezisë së Leavey-it, nuk është aspak rastësi. Ajo shpesh krahasohet nga kritika letrare me Emëllin Dikensonin. Leavey jep mësim Poezinë dhe Analitikën Letrare në Eastfield College.*

**HIJET**

E gjarpërojmë rrugën tonë ndërmjet pemëve, Shmangim mbërritjen e dritës së diellit, Këtu ku hijet kërcasin nën këmbë.

Brusha është e rëndë në këtë mal, E pamundur të pikturosh, në fjalë, në vaj. Por ne ecim hap pas hapi përpara, Duke ndërruar peisazhin me ç’do shikim.

**MMII**

Në 1942, gjyshja ime i dërgonte letra njeriut që dashuronte. Në erën e njelmët të Pacifikut, gjyshi im e nënkuptoi elokuencën e saj si një prelude të gjatë drejt seksit. Ne të gjithë e kuptuam këtë nga përgjigjet e tij. Unë hoqa dorë nga shkrimi i letrave

që nga dita që lexova të tyre. Mësova se durimi nuk qe një një virtut që mund ta praktikoj lehtësisht. Mësova për shpejtësinë e shpërdorimeve të botës— dhe për lamtumirat e shkruara.

Kush gjen kohë tani që të shkruaj një letër? E kush do përgjigjej nëse shkruaja? Kush duron të presë në rradhët e ngjeshura të postës për një pullë dhe aq më pak për një prelude të qelbur? Prapë, një letër e vërtetë do të ishte një befasi e mirëpritur.

**QYTETI I HARRUAR**

Kemi jetuar në një qytet prej hiri Për dy mijë vjet- Jetët tona të ngrira

Nga Vezuvi djegës: Ajo iu përgjigj fisnikërisë tonë Me hijen përvëluese vullkanike.

Unë kam përkëdhelur një qen të tmeruar, Kam luajtur Me fëmijë të përpirë

Dhe kam mbetur të gëlltit hi. Me pakëz shpresë Kam prituar ardhjen e arkeologëve.

Ata janë këtu tani. I dëgjoj tek pastrojnë Me furca çatinë e shtëpisë time, Zbulojnë dërrasat e dyshemesë të shtëpisë tonë.

Ata shkyejnë dyert e varrit tonë

# KREVATI I RI...

**Nga**

**Andrea**

**Witzke Leavey**

Dhe studiojnë mbeturinat e ftohta Në ngrohtësinë e qëndresës së Pompei-it.

**ODE PËR NJË ARI**

“Ai është duke folur për një vajzë,” tha ai. —nga “Ariu” i Faulknerit

Ju thatë se do të ishte tamam ç’na nevojitej. Kisha dyshimet e mi: Ju e dinit që i urreja kampimet. U nisëm në 5 të mëngjesit në mugëtirën bojë hiri. Ju më kapët për dore dhe më prurët poshtë shtigjeve te vende ku ndërprerjet dhe fëmijët nuk ekzistojnë. Ju ndërtoat kampin dhe më thatë, *Ruajtu ngrarinjtë.* Unë lëshova librin mes gjunjëve dhe kqyra dendësinë e pemëve.

Atë natë fjetëm kruspull në një thes gjumi. Unë ëndërrova për Benin, pashë thikën e Boonës tek ia preu fytyrën. Luani qe grirë copë-copë. Por në këtë ëndërr ariu mbijetoi; u shpërngul në anë të pyllit dhe u kthye të vështrorë me sy ngulitës e të zverdhur. Nga frika, t’u ngjita pas—dhe e mora me mend se pse më solle këtu.

**PENDESË**

Poetët nuk duhet të ngecin në trafikë të ngjeshur; ne duhet të jemi duke pirë verë dhe lexuar Poezi në verandën pas shtëpisë në dritën e zbehtë të muzgut, jo të rrimë në trafikun e Houstonit, duke u zvarritur nëpërmes flakërimeve të bardha ndarëse të tymit dhe shiut të helmuar. Megjithatë ja ku jam, në Hondën time të vjetëruar, ngecur në kohë të papërshtatshme, në kursi të papërshtatshme, pa patur një penë përdore. Unë vuaj pasojat e kësaj pendese për krimin tim të fshehjes brenda mureve të bibliotekave, duke mos parë sahatet tek haja fjalë falas. Tani zvarritem drejt shtëpisë, krah për krah qytetarëve të mirë, duke u ndierë fatlume që jam

e varfër —plotësisht e ndërgjegjshme se nuk jam edhe aq e varfër.

HAUKS NEST, ST. JOHN, USVI

**I**

Kodrat gjuhëzojnë rrugën e tyre te deti, sikur deti i kërkon tokës të rrëshqasë në gojën e tij të hapur në pritje. Pasqyra e lëmuar kaltëroshë është mashtruese: me kryet e mi nën mure kaq të patejdukshme, dikush mund të shohë për kilometra të tëra.

Çdo rreze apo fletë është spërkë dielli a ylberi para një drite të tillë.

Unë fle nën direkët e velave të boshatisura Duke dëgjuar linjat e holla të përplasjes kundrejt natës në prehje. Nga thellë në brendësinë e zorrëve të Pelikanit Hokatar

**II**

Unë shikoj lart dhe pretendoj se unë jam e rrahura e zemrës së tij. Unë jam më e zgjuar se aq. Ai është më i zgjuar se aq.

**III**

Vela e kap erën si një dorë Dhe varka jonë ngjitet lart, duke u mbështetur në kaltërsinë e bashkimit të qiellit me detin. Ne kemi besim te fuqia mbrojtëse e anijes. Deti dhe era dinë diçka më shumë.

**NJË QEN, SI LETËRSIA ARTISTIKE**

kërkon miratim dhe pret durueshëm. Kur e zgjoj, qoftë dhe pa dashur, ai kërcen më këmbë, ecën rreth këmbëve të mia, dhe luan bishtin —por unë do të eci me të kur të jem gati (shumë faleminderit). Një qen ha ç’i jap unë, llap mbeturinat e mia, dhe atëhere më vështron me sytë e rumbullakët kur s’ia var para se të fle. Ai nuk qahet tek gjendet i mbyllur në një kaqfaz të vogël.

**NJË MACE, SI POEZIA**

s’ka nevojë për ndihmë. Ajo bën si të dojë kur dhe ku t’i pëlqejë (shumë faleminderit). Ajo nuk jep paralajmërim

—veç futet drejt në vallëzim pa qenë e ftuar: e pasjellshme, fëmijë e rrembyer. Një mace hidhet mbi tryeza me një lëvizje të menjëhershme, fërkon bishtin e saj në fytyrën time, fut mustaqet në qumështin tim, gërvisht dhe fërshëllen kur unë a shtyj atë mënjane. Natën, bredh andej-këndeje në shtëpinë time, pa i shpëtuar asnjë dhomë, asnjë mi.

**GJËAGJËZA QË DËSHIROI PAN-I**

Me të njëzet sytë e përgjumur ai lutet ta mbash në duar: Unë përgjigjem me gishtinjtë e mi. E vendos atë në pëllëmbët e harkosura dhe gjarpëroj gishtinjtë mbi qepallat e tij. Ai nuk është asgjë pa gojën time përkundrejt gojës së tij—jo një puthje, vetem buzët ngjeshur pas buzëve të tij. Ai e pranon frymën time të gatshme; lagështira shpejt mbulon shpinën e tij. Unë vendos trupin e tij të hajthëm në një kënd të butë dhe qepallat i hapen dhe i mbyllen nën bulëzat e gishtërinjëve të mi. Me formë e hijeshi të matur, ai përçon argjend në tingullimë.

**KREVATI I RI**

Jam shtrirë zgjuar e frikosur: e druajtur se ajo mund të rrëzohet, e druajtur se ajo mund të harrojë. Por vetëm një qarje e përgjumur më tund nga krevati im: një nevojë e përkohshme.

Qëndroj në këndin e errësirës së saj dhe ia dëgjoj ritmin e butë të ngritjes dhe uljes së gjoksit. Unë thith ajërin e saj ambrosial edhe pse e di se jam vetëm një dëshmitar. Figura e saj formë-ylli prej vogëlushe bëhet gjithmonë më e kuptueshme. Tentativa e saj shpresëplotë që të përmbushë përmasat e krevatit falimentoit (sonte) nga barra dërrmuese e punës. Rojtari i djepit të zberthyer e mban vigjilin finok: kukullat, lojërat, batanijet, shtrihen të çliruara. Edhe unë gjithashtu çlirohem —pastaj bëj dorën grusht. Megjithatë e di se më duhet të bëj përgatitje për ndryshime.. E di se më duhet të bëj lëshime, copa-copa. E ndiej lehtësinë e perit të balonës që më rrëshqit nga dora dhe unë rri duke e shikuar.

Përherë më lart e më shpejt pa u ndierë fare, ajo largohet.